

VITI XV, NUMRI 6 / QERSHOR 2011

FOREVER



HUNGARY | ALBANIA | BOSNIA AND HERZEGOVINA | CROATIA | MONTENEGRO | SERBIA | SLOVENIA



BERKICS MIKLÓS
DIAMOND MANAGER

Të drejtosh me mençuri

E adhuroj këtë periudhë të veçantë të vitit. Çdo gjë na duket dhe e ndjejmë se është më e mirë dhe më e freskët. Duke flakur barrën e dimrit, çdo gjë përtërihet dhe vishet me ngjyra prallore.

Edhe ne këtu në zyrat qëndrore të FLP jemi me fat mbasi afër kemi një liqen që mbushet plot me zogj uji të ndryshëm. Herë herë shikoj sesi rosa mëmë drejton në ujë vargun e gjatë të rosave të vogla. Ajo i fut ato në ujë dhe i ruan kur dallgët e ujit dhe të erës i kolovitin. Pas një farë kohe ajo i mbledh dhe i nxjerr nga uji. Gjatë rrugës ndeshin diku një bllok që u pengon rrugën.

Rosa mëmë kërcen e para dhe pret në majë që edhe rosat e vogla ta kalojnë pengesën. Ajo pret me durim ndërkohë që

ato përpiqen, kërcen, bien e rrezohen dhe hidhen përsëri mbi pengesë. Ajo i inkurajon dhe u tregon atyre rrugën por kurrë nuk i tërheq ato shumë zvarrë. Duke parë këtë lojë të rregullt të rosave, instikti do të më shtynte të vrapoja, ti kap ato e ti ndihmoj të kalojnë pengesën, por kjo nuk do të ishte rruga për ti ndihmuar ato të forcohen dhe të bëhen të pavarura. Kjo do ti ndihmonte ato për një çast, por nuk do ti ndihmonte të bëheshin të afta për të mbijetuar dhe mësuar të luftojnë me jetën. Kujtoni rosat e vogla dhe mendoni punën tuaj me linjën poshtë jush. Ky është një mësim shumë i çmuar që mund ta mësojmë nga rosa mëmë.

Të drejtuarit është një cilësi e fuqishme dhe e veçantë që mund ti ndihmosh të tjerët të arrijnë shumë më tepër se sa kanë menduar. Unë mendoj se kushdo, pamvarësisht nga personaliteti apo eksperiencia, ka talentin e të drejtuarit. Por jo të gjithë ne e demonstrim atë në të njëjtën mënyrë. Ka disa që qëndrojnë në ballë; ata qëndrojnë në këmbë të vendosur duke gjeneruar nxitje dhe pasion. Ata janë karizmatik dhe njerzit duan të qëndrojnë afër tyre. Ka edhe të tjerët të heshtur që drejtojnë me shëmbullin e tyre duke gjeneruar rritje të qëndrueshme të vlerave dhe aftësive individuale. Stili nuk ka shumë rëndësi. Ajo që është kryesore është qëllimi final për të frymëzuar të tjerët për të realizuar atë që duhet.

Kohë më parë ndesha një shembull të jashtzakonshëm drejtimi, nëpërmjet një E-mail që i drejtohej një babai që e njihja. Mesazhi vinte nga një mësuese matematike e njohur për aftësinë dhe kërkesën e fortë të saj. Ajo është një profesioniste e vertetë dhe ashtu si rosa mëmë nuk dëshiron që fëmijve tu heqë ngarkesën e të mësuarit, por vetëm i mbështet ata që të mposhtin pengesat. Ashtu si me shumë njerëz të mëdhenj që përpiqen të bëjnë atë që është më e drejtë, edhe ajo ngjalli kundërshtim. Disa nxënës poterexhi po i krijonin një situatë të vështirë që po e mundonte. Duke parë këtë gjë një djalë 12 vjeç i doli asaj në krah...

Ja çfarë i shkruan mësuesja prindit të këtij fëmije:

„Sot në mëngjez kalova një ditë teper të vështirë nga sjellja e keqe e një nxënësi. Por pa vonuar shumë djali juaj më erdhi me një shënim ku shkruante, „Ju mësuese Brown jeni Mbret!“ Më iku inati dhe fillova të buzëqeshja! Janë këto momente, për të cilat ja vlen të vazhdoj”

Duke qëndruar në skenë, në takimin e Prillit në Vjenë, isha i rrethuar nga mijra vetë që bëjnë ç'është e mundur për suksesin e FLP. Pata privilegjin të ndaja çeqet e shperblimit Profit Share në një vlerë prej 9 milion dollar. Mendoj se ky është një nga programet më bujare të këtij aktiviteti. Çfarë kënaqësi!

Duke shijuar këtë takim me njerzit më të sukseshëm në botën e Foreverit në Vjenë, mu kujtua se parimi bazë themelor që i bën njerzit të sukseshëm në Forever është mirësia. Të gjithë ne duhet të sillemi pak si ajo rosa mëmë. Ti duam njerzit, ti drejtojmë ata dhe „të futemi në ujë bashkë me ta“, por të mos u heqim atyre barrën e të mësuarit dhe të rritjes dhe ti lëmë ata të luftojnë edhe vetë.



Rex Maughan
REX MAUGHAN
I JUJAI PËRGJITHMONË



Erdhi perseri vera!


Tashmë termometri tregon 28 °C, në qytet përzihen ajri i ngrohtë dhe pluhuri. Ajo që mund të bëjë njeriu është të kërkojë një vend me ajër të kondicionuar ose të kërkojë ndonjë lemonadë freskuese me akull. Ndoshta një çikë më herët se sa pritej, por prapë erdhi vera, duke na vënë para sfidave. Hap pas hapi fillojmë të shijojmë natyrën me dhuratat e bollshme që nga fushat me lule deri tek pemët që na japin frutat. Fëmijët vrasin mendjen ku do ti kalojnë pushimet, por edhe ne të rriturit fillojmë të planifikojmë pushimet e verës. Por për fat të keq sot në Europën Qendrore ka familje që nuk mund të mendojnë për pushime verore. Për ata kam një lajm shumë të mirë: nuk është akoma vonë të lidheni me programin Forever Holiday Rally. Do të dëshironit ti kaloni disa ditë në një nga vendet më të bukura të Kroacisë, në një mjedis luksi? Dhe të thithni aromën shëruese të detit, Ti kaloni disa netë në një atmosferë të shkëlqyer, të takoheni me biznesmenët më të sukseshëm të Europës dhe ndërkohë të mësoni nga lektorët tanë më të mirë ?

Do të dëshironit të shijoni gjellët më të mira të guzhinës kroate? Duke vazhduar kështu do të arrini deri tek kuzhina e mrekullueshme e kështjellës të Szirakut.

Atij që tashmë ka që në Porec nuk ka nevojë ti themi çdo të thotë Holiday Rally. Tashmë për njerzit e Foreverit Poreci është kthyer në një ide fikse sepse shumë prej tyre fillimin e ngjites përpjetë në karrierën e tyre në FLP ja dedikojnë trainimit në Porec. Ky është një stacion i rëndësishëm dhe një avantazh i madh edhe për lektorët e instruktorët tanë mbasi leksionet e tyre mbeshtesin të ardhmen e rajonit tonë të Europës Qendrore e Juglindore. Ju sigurojmë se në Porec do të jenë lektorët më të mirë të botës dhe do të bëjnë gjithshka që varet prej tyre për tju dhënë juve më të mirën e dijeve të tyre. Edhe zëvendës presidenti i FLP për Europën Aidan O'Hare gjatë takimit me ne ka vlerësuar rëndësinë e trainimit në Porec.

Keni rastin që të lidheni me ne! Na lejoni që të kapemi për dore, dhe tju drejtojmë në atë rrugë, në rrugën e Foreverit, që Rex Maughan, drejtori i përgjithshëm i FLP ëndërroi dhe realizoi tashmë prej 33 vjetësh. Uroj që gjithkush të marrë vendimin e duhur, të takohemi në Porec dhe të kthehemi prej andej jo vetëm të pasuruar me përvojë.

Përpara FLP Hungari!



DR. MIELESZ SÁNDOR
DREJTOR I PËRGJITHSHËM



DIAMONDS


are

FOREVER

Success Day

DITA E SUKSESIT E MUAJIT MAJ ISHTE MË
E VEÇANTË NGA TË TJERAT, PRANDAJ
DHE NUK U HABITËM QË TRIBUNAT
ISHIN PLOTË E PËRPLOTË. GJITHSECILI
DËSHIRONTE TË FESTONTE 14
VJETORIN E KRIJIMIT TË FLP HUNGARI,
DHE DONTE GJITHASHTU TI SHIKONTE
EDHE NJË HERË 4 DIAMANTËN NË
SKENË.

Mbritëm në qëndrën Syma në një Ditë Suksesi festive të veçantë. Me këtë rast edhe **Lui** nuk i fillon i vetëm vargjet e himnit të Foreverit, atë e shoqëron **Zoltán Mága** dhe një orkestër e madhe. **Dr. Endre Seres dhe Dr. Katalin Seresné Dr. Pirkhoffer**, si drejtues të programit prezantojnë **Dr Sandor Miliesz**, Drejtor i Përgjithshëm cili fillon me fjalët „ Po festojmë ditëlindjen” Por ka edhe një arsy tjetër për këtë gëzim, Në Vjenë, në Rally-in europian doli që FLP Hungari së bashku me rajonin sllavojugor dhe të tjerët në realizimin vjetor zuri vëndin e dytë në Europë. Dhe ashtu sikurse shpresonim, edhe këtë radhë çmimi Spirit Award për skuadrën më të frymëzuar, më të lidhur dhe më unike.





Dr. Sándor Milesz njofton se Rally European i 2012 do të bëhet në Budapest., që shoqërohet me ovacione, pastaj bën të ditur programin e shperblimit 100% të pikëve nga blerja personale. Kështu fillon bukur ditëlindja.!

Lenkey Péter na rikujton se **Rex Maughan** në kohën e vet nuk krijoi vetë një firmë por edhe një filozofi të re. Vlera të tilla themelore që pasuesi i merituar **Gregg Maughan** është në gjëndje ti çojë më tej në shekullin e 21-të, Drejtori operativ i Europes përmendi energjinë e palëkundur dhe aftësitë profesionale me të cilat Dr Sándor Milesz drejton prej 14 vjetësh këtë firmë. Por nuk harron as bashkpunëtorët duke falnderuar këto që ka zënë vënd në stadium së bashku me menaxherët diamantë. Mbase „nga ju përbëhet Foreveri” - thotë ai, ju jeni pjesë e zhvillimit 33 vjeçar. Ajo ka kuptim kur ngrihem dhe kur bie, se ka ndodhur diçka. Për këtë flet firma, dhe për respektin reciprok, sigurisht këtu merr vlerësimin. Sipas Lenkey duhet të festojmë jo vetëm për historitë e deritanishme por edhe për të ardhmen „sepse sot duket se si do të jetë e nesërmja” Mos u përgjum, sepse ai që përgjumat vdes. Nisuni me objektiva, merrni një vendim, dhe shikoni përreth, këtu të gjithë kemi lindur fitimtarë.”

Pastaj Lenkey Péter pret në skenë zëvendës presidentin e FLP për Europën **Aidan O'Hare** të cilin duke u ngitur në skenë brohoritet nga publiku. „Gjithmonë të ndez ky biznes!” – buzëqesh zëvendës presidenti. „Mrekulli! Në Vjenë gjatë një dite u shpërndanë 6 milion Euro

Pastaj Aidan rreshton të dhënat për shitjet, ku me shëmbullin që na jep për Turqinë, na tregon se Foreveri ka gjithmonë jo vetëm një mundësi. Por ndoshta nuk do të ketë nevojë për atë sepse dihet që nga koha e qëndrimit në nivel european, xhirua e muajit mars ishte edhe 8% më e lartë krahasuar me vitin e kaluar „Nuk ka mundësi tjetër më të mirë në botë, për këtë mund tju premtoj” – thotë Aidan, dhe ai që është laguar prej këtej një herë nuk ka gjetur më mirë se tek ne.

Këtu janë profesionistët më të mirë, prandaj shfrytëzoheni këtë mundësi. Mos harroni, po nuk u dorëzuar, nuk keni për tu rrëzuar!”





Pastaj Aidan thërret në skenë katë diamantët që tashmë janë ngjitur, **Kim Madsen** që ka ardhur nga danimarka, çifti Lomjanski, **Kati dhe Attila Gidófalvi** si dhe më të freskëtën që titullohet sot, **Miklós Berkics**.

„Ja të tillë janë, si edhe ju që jeni në sallë- thotë Aidan duke treguar ata. „Vetë në dy gjëra mund të jenë ndryshe, ndoshta i kushtojnë më shumë kohë dhe nuk dorëzohen kurrë”

Zëvendës presidenti u jep kurajo fillestarëve, në momente të vështira shumë vetë dorëzohen, ndërsa nuk u lëshojnë terren sfidave. „Kush do të jetë diamanti i ardhshëm? – shtron ai pyetjen. Pastaj vazhdon, „sipas bindjes time, në këtë vend është pasioni më i madh. Në të ardhmen, këtu në Budapest do të ndajmë shumë çeqe. Çështja është se në emër të kujt do të jenë? Të premtoj edhe ty, që edhe në emrin tënd do të ketë, sepse sot është dita, kur me ardhjen tënde këtu ti ke investuar në të ardhmen tënde.”

Attila Pataky dhe Zsolt Gömöry me orkestrën Android shfaqin një nga numurat e tyre më të njohur, Lutjen, pastaj vijon kualifikimi i supervizorëve dhe i asistent menaxherëve nën drejtimin e senior menaxherit Péter Szabó.

Dhe andej nga nisi gjithshka: në skenë ngjitet **József Szabó** „U bëtë edhe më të mirë nga unë, por s’ka gjë. E rëndësishme është ajo që në mesin tuaj ka nga ata që jeta u ka ndryshuar rrenjësisht- thotë ai në mënyrë modeste, pastaj shikojmë filmimet e prezantimeve të hershme, ku sipas pohimeve të një paraardhësi të madh „është bërë çdo gabim që mund të lejohej”. Por sot nuk ka rëndësi ajo, por që sot nuk ka gjë të pamundur. këtë Józsefi e vërteton në mënyrë prekse me historinë e tij. Me aq zemër, me aq vrull, me aq dëshirë e tregon që ta besojmë.” Çdo ditë bëji mirë dikujt, dhe duke u udhëhequr nga kjo, dhe sikurse thotë, duhet kapur edhe momenti” kur të jepet rasti, shfrytëzoje, sepse do të jetë von kur ta kuptosh sa e vlefshme ishte- vazhdon ai, ndërkohë që videoja ecën duke na treguar vizitën e 11 viteve më parë në Njujork të grupit hungarez të FLP.

Vri mendjen me të sotmen, jeto të nesërmen- ky është mesazhi.” E jani, ta bëjmë FLP edhe më të madhe”- me këto fjalë largohet nga skena, duke ja dhënë fjalën **Vera Lomjanskit**, një legjende tjetër të FLP.





„Vetëm nga ti varet si i shfrytëzoni, mundësitë që të jep FLP.”- thotë diamant menaxherja, dhe shpejt të qetëson kur thotë se askush nuk është i vetëm në këtë betejë, sepse mbrapa ke një mbështetje serioze. Veronika thërret pranë vetes skudrën e saj me serbë e hungarezë „Çdo mëngjes i përshëndes, Si jeni”, Pastaj vjen bashkëshorti i Veronikës, **Stevani**, të cilin e prezanton si drejtuesin numur një për çeshtjet ideologjike dhe logjistike. „Gaboresh, nqse mendon se gjithshka ka vajtur lehtë, thotë ajo duke treguar rezultatet. „Por nqse janë në raport të drejtësukeset dhe dështimet, atëhere do të ecësh përpara. Unë kudo kam punuar si punëdhënëse, kurrë në vetvete. Por kjo firmë ta vlerëson punën dhe sipas bindjes time, nuk ka biznes tjetër ku të fitosh shumë para pa investuar. Sigurisht nuk është kjo më e rëndësishmja, por ajo që vret mendjen edhe për të tjerët. Por për këtë për herë të parë kam marrë një vendim, për të cilin mos kini dyshim, luftoj m eveten dhe jam autokritike: unë edhe si diamante e dëgjoj këshillën e të tjerëve.” Durim, elasticitet, frymëzim, forcë tërheqëse- këto elementë Veronika i konsideron çelësin e suksesit.

Si një pije freskuese relaksi mund të shikojmë produksionin e tre tenorëve: **Lui, Tibor Éliás dhe Miklós Berkics** këndojnë për ne, ndërsa nga **Attila Gidófalvi** dëgjojmë kredon e tij.

„Paçi një ëndërr!”- na thotë diamanti i dytë, por në botë ai që e ka arritur më shpejtë, i cili ka vetëm një ëndërr: në të ardhmen le të jemi të parët në Europë. Atilla shikon edhe nga ata që tani njihen me këtë mundësi: përshëndet „balozët e parë”, dmth ata që akoma nuk kanë ardhur në ditën e suksesit. „biznesi bëhet i tillë siçe bën ti - u thotë atyre, na thotë neve, por duhet ta ndjesh, duhet ti premtosh vetes, familjes. Nqse duhet kohë , gjeje atë, se nuk do të shkojë kot. Por nuk duhet thënë „po e provoj, atë duhet ta duash seriozisht. Tregoje se cili dëshiron të jesh dhe ai do të bëhesh. Ndërkohë Attila, tërheq vëmendjen se edhe me egon duhet të dish të



sillesh, pastaj na tregon edhe shëmbullin duke na treguar , se nuk është ajo gjë e madhe, nëqse dikush është diamant, por nëqse në biznes janë dy diamantë- duke ju referuar Miklós Berkicsit.

Por as jeta e tij dhe e bashkëshortes të tij Kati, nuk ishte gjithnjë e ndritur” me mund e ndërnuam biznesin”- përfundon ai. „Nu qeshë i lumtur kur pashë se kish që ishin jo vetëm të pasur por edhe të lirë. Por eca dhe i arrita ata”

Nuk jam akoma atje, ku do të doja, por nuk do të ndrohesh me askënd. Koha ikën si kështu, si ashtu. Gjithmonë të jetosh më mirë, bashkë me grupin – le të jetë ky qëllimi i fundit.

Më pas çifti drejtues i programit fitoi në skenë vajzën e tyre: **Dóra Seres** flautiste që vazhdoi nën shoqërimin e një grupi të madh muzikor. Drejtimi i mrekullueshëm për festimin e të kualifikuarve : sundimtarëve, menaxherëve, pretendentët e targave FLP, senior menaxherëve, antarëve të Business Builders Club, eagle menaxherëve, antarëve të Klubit të Presidentit dhe të kualifikuarve në Super Rally.

Kim Madsen krahas Danimarkës që është shtëpia e tij, punon edhe në njëzet e katër vende të tjera. Pse u bë diamant? Siç dëgjua nga shumë të suksesshëm të tjerë, prandaj, sepse i premtoi vetes. Si fëmijë ka pasur gjithashtu një jetë të vështirë. U rrit pa prindër, dhe siç thotë, “nuk ka pasur ditë, që të mos talleshin me ëndrrat e tij. Vendosa, që të bëhem i suksesshëm, i madh, dhe do të luftoj.” E gjithë kjo ishte më serioze pa përfunduar një shkollë, sepse Kim-i u bë marinar që 17 vjeç, por sikurse thotë, e ndjente veten askushi. Më tej pasuan prova në biznese të ndryshme që përfundonin me dështime, deri sa në fund në moshën 22 vjeçare gjeti network marketing-un. “Kjo u bë jeta ime”-thotë Kim që punon prej 13 vjetësh me Forever-in. “Në mëngjes ngrihem me mendime të mira dhe shkoj në krevat i kënaqur”-tregon babai jo vetëm i dy fëmijëve të tij por dhe i katër fëmijëve të birësuar.





“Dua t’ju tregoj atyre rrugën drejt suksesit. Se si nga askushi të bëhesh dikushin-ky është një nder i madh. Edhe prej teje mund të bëhet tjetër, nga ai që je” -thotë diamanti danez, i cili për herë të parë morri në 2003 Profit Sharing të shkallës së tretë: me vlerë prej 50000 euro, më pas brënda 9 vjetëve pasuan çeçe në vleftën e 5 milion dollarëve. Dhe një limuzin, dhe një vilë me 20 dhoma gjumi... por Kim-i thotë që kjo në vetvete nuk jep shumë. “Gjej, çfarë jep lumturinë e vërtetë!”

N.q.s. e pyesin drejtuesin se sa orë punon, thotë, zero, sepse për atë kjo nuk është punë. “Nuk jemi superheronj, vetëm përdorëm mundësin.”

E dimë që **Attila Gidófalvi dhe Kim Madsen** i premtuan vetvetes, që do të arrijnë deri këtu. Po **Miklós Berkics** çfarë e motivi? Në fillim kundërshtarët, por kjo nuk zgjati shumë. Më vonë provoi të shfrytëzonte forcat e vetes, por as ajo nuk ishte e vërteta. “Duhet ta bëj për Rex-in!”-i ra ndër mend këtë herë, sepse “Rex-i ka çdo gjë, nuk kemi çfarë ti japim tjetër, veç lumturisë. Jepi lumturi atyre, që të sollën në këtë biznes.” Nga ky moment skena është e Miklós-it, në fund fillon një festim i paparë. E gjithë salla është në këmbë, duke ndriçuar me llampat e dorës të bëra me kuti First-i. Miklós-i këtu nuk feston vetveten, por të gjithë ata që e ndihmuan në këtë sukses. Falenderon vitet e shkuara me nga një trofe shkëlqyese apo me lule. „Një diamant as nuk thyhet, as nuk gërvishet. Biznes me forcë atomike, por që do mbrapa vetes një punë të fortë. Nga guri bëhet

diamanti: ky biznes nxjerr prej teje më të mirën.”

Nga salla dëgjohet ritmikisht „Bravo Miki”.

Lexuan mesazhin e Rex-it: „të uroj me gjithë zemër dhe të ndjekim me vëmendje kur do të bëhesh dopio diamant!” Qarkullojnë fotot e një albumi, një me një të ri që dikur kishte mustaqe, ndërsa Károly Nyári këndon My way. Më pas nuk mbetet gjë tjetër, veçse të kualifikohen assistant supervisorët, diamantët e ardhshëm.





SHËNDET të gjithëve!

KËTË HERË EDHE KOHA ISHTE ME NE, KËSHTU DITA E SHËNDETTIT II. NË SHESHIN LIRIA TË BUDAPESTIT U MBYLL MË E SUKSESSHME SE NJË VIT MË PARË. NË TRE SKENA U MBAJTËN LEKSIONE NON STOP, PJESËMARRËSIT MUND TË MERRNIN PJESË NË TRIDHJETË LLOJ KONTROLLESH SHËNDETSORE, DHE KRAHAS KËSAJ ATMOSFERË TË MIRË GARANTUAN PROGRAMET ARGËTUESE DHE ATO TË FËMIJVE.



Njerëzit vijnë këtu me pak frikë, por kur i thërrasim ata, i provojnë kremrat me kënaqësi” – thotë tek qendra e Sonya-s Krisztina Hasznosi. Shumica kërkuan këshilla për atë, se simund ta bëjnë lëkurën më të tërhequr, më të bukur në fillim të verës. “Duket që njerëzit akoma e kanë të vështirë të sakrifikojnë për kozmetikën, kështu që u munduam ti ndihmojmë ata me trajtimin e lëkurës në shtëpi”- tha specialisti.

Mónika Hudra Matalikné mbritti nga Gyöngyösi me dy prej tre fëmijëve që ka, të cilët nuk kanë shumë dëshirë të shkëputen nga këndi i lodrave. Ashtu siç thotë, nuk është e lehtë ti rrisësh vogëlushët në mënyrë të shëndetshme. „Atë që shohin në TV dhe nga shokët e klasës, në të vërtetë nuk flet për shëndet. P.sh. djali im ishte pothuaj i varur nga pija energjike, sot për fat edhe për atë ka një alternativë më natyrale. Edhe në mënyrën e të ushqyerit përpiqemi t’ju kundërpërgjigjemi efekteve negative me perime, por për fat të keq vlerat ushqyese të tyre nuk janë si më parë, kështu që duhen plotësues ushqimorë”.





Ndoshta rreshtat më të gjatë edhe këtë herë gjarpëronin në pikat ku bëheshin matje të ndryshme, por të gjithë prisnin me durim në testin e fitnesit, të stresit, për matje kardio, për kontroll tensioni dhe të frymëmarrjes. “Janë jashtëzakonisht të këndshëm, ndihmësit janë të dashur, punojnë thjesht nga dashuria dhe duket që e kuptojnë zanatin”: tha një zonjë e moshës mesatare.

“Më pëlqen ta bëj këtë. Këtu leksioni mund të jetë një grad më “i shkujdesur”, se në një forum profesional. Sepse nuk vijnë vetëm antarë të Foreverit, por kushdo, që ka pyetje për shëndetin. Ishte kënaqësi të shikojë sy që shkëlqenin. Tema ime ishte për pastrimin e organizmit, ku shumë prej tyre e kuptuan, që ajo sasi e madhe ushqimesh që marrim gjatë të ngrënit, në një farë mënyre duhet ta ekuilibrojmë. Nuk është e lehtë të kthehesh menjëherë në një mënyrë jetese të shëndetshme, por ky program tregoi, se kush është ajo rrugë, në të cilën duhet të nisemi. Dhe n.q.s. nuk ndjehet akoma rezultat në numër, tani duket ndryshim ndryshim në mentalitet.”

Dr. Ilona Juronics soaring manager



Lóránt Ötvös nga Budapesti antar rrjeti prej dy vjetësh, edhe vjet ndodhej këtu. Atëhere u lagën pak, kështu që tani i gëzohen kohës së mirë. “Sapo dëgjova Tamás Budai, ai gjithmonë di të thotë diçka të re edhe për sportin, edhe për menaxhimin. Programi është i ngjeshur dhe nuk është e mundur ti shikosh të gjitha, por kështu të paktën ke mundësi të mësosh shumë nga kjo llojshmëri leksionesh”.



“Prandaj është i mirë ky program, sepse këtu dalin në sipërfaqe probleme shëndetsore dhe menjëherë po këtu është edhe zgjidhja. Është rast i mirë për tu njohur me njerëz të rinjë, t’ju prezantojmë produktet, sipermarrjen tonë. Me këtë u hap një kanalizim i ri për të gjithë ne. Edhe vjet gjetëm pesëgjashhtë blerës të rinjë, mes të cilëve me tre kemi lidhje të vazhdueshme edhe sot. Ndërsa bashkpunorët e mi prandaj kam dëshirë ti ftoj, sepse këtu mund të shohin përmasat, fuqinë që fsheh firma”.

András Láng, senior eagle manager





Në çadrën e Fönix Szalon Zoltán Siklós dhe Dr. Edit Révész Siklósné përfunduan me një kujdesje të madhe matjet me pajisjen N20 analizues të trupit. "Që nga mëngjesi masim në vazhdimësi-thotë Zoltán-jemi në gjëndje të përcaktojmë raportin e kockë-muskuj dhe të yndyrnave në organizëm, qoftë duke e shpërbërë edhe në pjesë të veçanta të trupit." Dhe e provuam në realitet: brënda një minute rezultati ishte gati. Mësuan, që a kanë mbipeshë, a vuajn nga mungesa e ndonjë lëndë minerale dhe atë, që n.q.s. po, me cilin produkt mund ta plotësojnë. "Tek antarët e Foreverit masim të dhëna shumë herë më të mira. Nuk është çudi, sepse tek ata mënyra e të jetuarit është e shëndetshme. Shkalla e lëndëve minerale tek ata është 1-1,5% me vlera më të mira se e përgjithshmeja, ndërsa rezultatet e tjera janë 20-30% më të mira!"



U zhvilluan edhe prezantime të jashtzakonshme produktesh, mund të provoheshin pajisje trajnimi për vibrim trupi, për masazh këmbësh, pajisje për masazh koke dhe rreth syve. Çadra e firmës nga Singapuri ishte me të vërtetë popullore, ashtu siç tha edhe përfaqësi i sipërmarrjes: "shumica e njerëzve vuajn mungesën e kohës, nuk kanë kohë të lëvizin ose kanë turp nga mbipeshë në sallat e trajnimit. Ndërsa kështu në shtëpi brënda 10 minutash është në gjëndje të vërë në lëvizje veten."



Kriszti me shoqen e vet nga Pesterzsébet presin leksionin e Terézia Samu-t. Siç thonë, ka shumë leksione interesante. „Ishte me shumë vlera edhe leksioni për alergjinë, dhe për shëndetin e fëmijëve, por m.q.s. në familjen tonë dominon kolesterina e lartë, temat për kardiologjinë janë më të rëndësishme- prandaj erdhëm në rradhë të parë.”



Mësuesja e baletit nga Isaszeg-u u jep ora aerobie sipërmarrësve spiritualist. „Nuk ka rëndësi se çfarë lloj lëvizje zgjedh, e rëndësishme është që ta duash atë që bën. Kush dëshiron të çlirohet, të kërcejë, për ata kjo lëvizje është një pushim, që i forcon fizikisht dhe shpirtërisht. Në pushim të leksioneve i provuam pak, sepse mund të flitet për shumë gjëra, por kryesore është praktika!”



Zsolt Fekete mezi priste, që të dinte çfarë do të thonin për leksionin e tij. „Ka akoma shumë pikëpyetje në kokën e njerëzve. Shumë nuk e kuptojnë, që dieta dhe sporti nuk zëvendësojnë njëra-tjetrën, vetëm së bashku kanë kuptim të dyja. Por nëse dikush vjen në një ditë të tillë, ai dëshiron diçka, kërkon zgjidhje për diçka. Këtu mund



„Si anëtar i President's Club vendi im është këtu, përfaqësoj firmën në të gjitha programet e mëdha. Dita e Suksesit dhe rastet e ngjashme me të flasin për mësimin, motivimin dhe vlerësimin, ndërsa kjo për civilët është një mesazh, që të jenë të hapur në drejtim të shëndetit, të marrin fatin në duart e tyre. Doktorin nuk ikën në shtëpi, ndërsa këtu mund të bëjnë të gjitha kontrollet. Këtu nuk është qëllimi, që menjëherë të njihen me imtësin me planin e marketingut apo ndërtimin e firmës, por është një rast i mirë, që të bëhet hapi i parë dhe të nisë komunikimi”

Tibor Lopicz, senior manager

FOREVER 

EUROPEAN RALLY *be free*
BUDAPEST 2012



FOREVER 

EUROPEAN RALLY *be free* BUDAPEST 2012

RALLY EUROPIAN BUDAPEST, HUNGARI


24-25 SHKURT 2012

E RËNDËSISHME: NË QOFTË SE SPONSORIZIMI BËHET PAS KORRIKUT ATËHERE NUK MUND TË KUALIFIKOHESH

NIVELI 3

Plotësoni 95 CC (bashkë me pikët personale) me skuadrën tuaj të re


- ★ 2 BILETA HYRJE NË RALLY
- ★ NETË NË HOTEL
- ★ UDHËTIMI ME AVION



NIVELI 2

Plotësoni 50 CC (bashkë me pikët personale) me skuadrën tuaj të re


- ★ 2 BILETA HYRJE NË RALLY
- ★ 3 NETË NË HOTEL



NIVELI 1

Plotësoni 20 CC (bashkë me pikët personale) me skuadrën tuaj të re

- ★ 2 BILETA HYRJE NË RALLY



Sponsorizo minimumi 3 distributor të gjeneratës direkte, të cilë arrijnë nivelin Asistent Supervisor. Të kualifikuarit të jenë "aktiv me 4 CC" për çdo muaj gjatë periudhës të kualifikimit. Periudha e kualifikimit fillon nga 1 Korriku i 2011 dhe zgjat deri 31 Tetor 2011. Gjatë periudhës të kualifikimit duhen plotësuar të gjitha kushtet.

Sponsorizo minimumi 3 distributor të gjeneratës direkte, të cilë arrijnë nivelin Asistent Supervisor. Çdo distributor i ri duhet të arrijë pikët e dhëna sipas skicës. Të kualifikuarit të jenë aktiv në çdo muaj të periudhës të kualifikimit. Periudha e kualifikimit fillon nga 1 Korriku i 2011 dhe zgjat deri 31 Tetor 2011. Gjatë periudhës të kualifikimit duhen plotësuar të gjitha kushtet. Data e hyrjes është ajo e regjistrimit të të dhënave të tij në sistemin kompjuterik të kompanisë qëndrore. Në këtë program motivues kanë vlerë vetëm blerjet e bëra brenda rajonit. Çdo distributor i linjës së poshtme duhet të zotërojë adresë brenda rajonit. Çdo distributor mban përgjegjësi për kuptimin e duhur të kushteve të programit motivues. S'ekziston mundësia e trajtimit të veçantë. Programi motivues përmban vetëm kushtet dhe shpërblimet e shfaqura në figurë. Për çdo pyetje që këni drejtohuni drejtorit tuaj gjeneral. Shpërblimet nuk mund të shkëmbehen në para dhe shpërblimet nuk mund t'u jepen të tjerëve.



PROFIT SHARING 2010

MIKLÓS BERKICS
nívél II.

ARANKA VÁGÁSI & ANDRÁS KOVÁCS
nívél I.

STEVAN LOMJANSKI & VERONIKA LOMJANSKI
nívél I.

SÁNDOR TÓTH & EDINA VANYA
nívél I.

TAMÁS BUDAI & ÉVA SCHWARCZ BUDAI
nívél I.

TÜNDE HAJCSIK & ANDRÁS LÁNG
nívél I.

ISTVÁN HALMI & RITA MIKOLA HALMINÉ
nívél I.





HAJNALKA SENK
níveli I.

DR. KATALIN PIRKHOFFER DR. SERESNÉ & DR. ENDRE SERES
níveli I.

GÉZA VARGA & DR. ILONA JURONICS VARGÁNÉ
níveli I.

DRAGANA JANOVIĆ & MILOŠ JANOVIĆ
níveli I.

TIBOR LAPICZ & ORSOLYA LENKÓ LAPICZNÉ
níveli I.

ÁDÁM NAGY & BRIGITTA BELÉNYI NAGYNÉ
níveli I.

ÁGNES KLAJ
níveli I.

MÁRTA ZSIGA
níveli I.



ANDRÁS BRUCKNER DHE DR. TERÉZIA SAMU SOARING MENAXHERË

ÇËSHTJA SHËNDETËSORE E VËRTETË

NJË DOKTORESHË DHE NJË INXHINJER: NJË ÇIFTËZIM I MIRË NË BIZNES, SI DHE NJË BASHKIM I MIRË I DY TIPEVE TË NJERËZVE, I TIPIT MELANKOLIK-KOLERIK DHE SANGUIN. DR. TERÉZIA SAMU DHE ANDRÁS BRUCKNER JANË TË KËNAQUR ME ATË QË KANË ARRITUR DERI TANI – POR PRAPË NUK QËNDROJNË.

Forever Living Products në një ditë prilli hapi zyrën e tij në Hungari.

Ju u lidhët në nëntor. Ku u vonuat?

T.S.: Ky nuk ishte rrjeti jonë i parë, edhe në firmën tjetër punuam me përgatitje me bazë bimë mjeksore dhe me plotësues ushqimorë, dhe atëhere unë nga njëra anë isha mjaft besnike, nga ana tjetër isha e dhënë pas produkteve. Për hapjen e Forever-it morrëm ftesë nga dikush, por për ne personi nuk ishte i besueshëm, kështu që e lamë. Personi i dytë u morrë me shpjegimin me imtësi të planit marketing, por për produktet vetëm aq dinte të thoshte që mjalti është i shijshëm. Kjo për mua ishte pak. Së fundi Ági Krizsó dhe János Szabó – atëhere ishin bashkëshort – ishin ata, që më folën në mënyrën e duhur: në rradhë të parë më treguan për produktet. Bile, Ági më trajtoi me Fleur de Jouvance, dhe kur dolëm nga banja, bashkëshorti nga fundi tjetër i dhomës së pritjes përplasi duart dhe tha: Ági ti më bëre mua një grua të re! Ishte mjaft bindëse, por në fund rezultati varet nga ajo, që kush të flet dhe si.

Ka mundësi që këtë përvojë edhe ju e përdorët kur flisnit me të tjerët

T.S.: Unë gjithmonë flas shumë me njerëzit, shikoj me kujdes që mundësia jonë ku mund të gjej alternativë në jetën e tyre. Me secilin flas sipas natyrës që ka, kështu që asnjëherë nuk munda të flas sipas „formulës së thirrjes”.

Keni durim të dëgjoni deri në fund ankesat e njerëzve?

T.S.: Më shumë. Mund të them që kemi fat me atë, që jemi një vend gjithë ankesa. Vetëm kështu mund të kuptojmë, çfarë problemi kanë njerëzit, çfarë pretendimesh kanë, çfarë i nxit ata. Ndërkohë unë drejtoj me pyetje. Sigurisht kjo është vetëm një lloj gjysëm piktimiti, pastaj më vonë personi vendos që do apo nuk do.

E kanë zakon të duan?

T.S.: Kjo në rradhë të parë varet, a e pyet mirë. Këtë e kam mësuar nga Emil Tonk: për të gjithë të njohurit ke nga një mendim, çfarë është i rëndësishëm për të, është më shumë biznesi, është më shumë produkti apo që të dyja... Shkruan të njohurit dhe pranë secilit tetë ose dhjetë pyetje. Më pas me një kontroll të fortë heq nën pyetjet, të përsëriturat, dhe mbeten ato që kanë peshë me të vërtetë. Si janë fëmijët, prindërit, si ndjehesh në vendin e punës, si e ke shefin, shoqërin, të vlerësojn, ku ishe për pushime, për ku po përgatiteni... do të kesh një magazinë të tillë pyetjesh, që n.q.s. i mëson mirë, me këto në çdo kohë del nga situata. Gjithmonë ju ofroj mënyrën, dhe një në dhjetë persona duan ta bëjnë.

Po të tjerët? A ju mungon zelli? A ka kërkesa më të larta se të tuat?

T.S.: Zakonisht thonë, që jam shumë maksimaliste, dhe ka diçka të vërtetë brënda saj. Unë kam hequr dorë nga shumë huqe, më shumë nga sa kanë pritur të tjerët prej meje. Por është fakt, që kanë shumë rrëmujë në mendje, dhe për këtë shumë gabim kanë edhe ndërtuesit e rrjetit, të cilët zgjojnë iluzione të gabuara, sipas së cilit këtu nuk duhet punuar shumë, mjafton që të flasësh me







disa njerëz dhe vërshojnë parat. As nuk bëhet fjalë për këtë, ky është një zanat shumë i vështirë, të cilin duhet mësuar dhe praktikuar. N.q.s. do të donim të kursenim ndonjëherë prej tyre, ajo do të ishte garanci për dështimin. Dhe shumë duan të kursejnë.

Kujtuat Emil Tonk. Prej kujt mësuar shumë akoma, gjëra me vlerë, variante...

T.S.: Variantet e mira janë të pallogaritshme, në të gjithë programet dëgjon të paktën një fjalë kyç, për të cilën tamam atëhere ke pasur nevojë. Dhe jo, sepse atëhere e dëgjove për herë të parë, por më mirë sepse atëhere të gjeti, atëhere ishte i hapur për atë. Frekuentoj edhe trajnime të jashtme të shitjeve, sepse edhe ne shesim, në mos tjetër, veten tonë. Kurrë askush nuk do të blej produkte, n.q.s. nuk dita të shes veten tek ai. Kjo e gjithë ndërtohet mbi besim, dhe për besimin duhet punuar.

Dhe çfarë është ajo, që mësuan të tjerët prej teje? A keni „shenjën tuaj” në diçka?

T.S.: Nuk besoj, që unë kam gjetur gjithshka, ndoshta vetëm një gjë, një parim bazë. Çfarë është ajo, që duhet të dimë për aloe verën? Të pastron nga helmimet, të ushqen, normalizon funksionet e jetës. Këtë në një Ditë Suksesi, publiku... me mua dhe që atëhere e kam dëgjuar përsëri nga shumë vende. Janë tre çështje themelore – nuk ka nevojë për më shumë se kaq.

Nga shumë vetë kam dëgjuar mendimin, që ti mban leksionet mjeksore më të ... -bile përmëndësh

T.S.: Do të doja, që të gjithë ta kuptonin, sepse n.q.s. do ta kuptojnë, atëhere ajo është e kopjueshme. Nuk janë fjalë latine në një komentues fjalësh. Provoj ta paraqes temën në formë loje, me figura dhe zgjuarsi, pavarisisht, që në brëndësi nuk jam një njeri i humorit, por pikërisht për këtë i ndërtoj me humor leksionet e mia. N.q.s. qeshin atëhere e kuptoj që po më ndjekin.

Dhe me çfarë stili drejton?

T.S.: Më demokratik seç duhet. Duhet të mësoj akoma, që të delegoj më shumë gjëra dhe n.q.s. është e nevojshme, të

drejtoj me forcë më të plotë. Në të njëjtën kohë duhet t’ju lë hapsirë edhe të tjerëve. Këtë betejë në rradhë të parë duhet ta fitoj me veten

Nga praktika spitalore kalove në botën e krijimit të rrjetit, më parë punoje si kirurgje e enëve të gjakut. E mendon atë si një periudhë të humbur, të mbyllur?

T.S.: Ndonjëherë shikoj ëndrra me të, dhe edhe atëhere më jep atë ndjenjë që mjaft me këtë, merrja përsipër këtë apo atë shërbim roje, por tani nuk e bëj më. Tashmë jam jashtë edhe nga ëndrra, e adhuroja profesionin dhe as e merrja me mend, që do të bëja ndonjëherë ndonjë gjë tjetër, por e mbyllën klinikën ku punoja, dhe atë punë që duhet të bëja në vend të saj nuk e doja.

Kështu u bërë promovues ilaçesh për mjekët, më pas krijues rrjeti. Ka diçka që të mungon nga jeta „e mëparshme”?

T.S.: Operacionet për shumë kohë më mungonin, por jo shërbimet e rojes. Më në fund kisha krishtlindje, vit të ri, më parë tek ne darka e shenjtë bëhej shpesh në 23... Kur disa herë kthehem mbrapa në kohë, gjithmonë kam atë ndjenjë, që sa mirë është për mua. Që është mallkim apo bekim, kjo do duket në fund.

Edhe këtu jep këshilla të profesionit. Çfarë të tregon kjo më shumë?

T.S.: Në jetën time kam dëgjuar shumë fjalë boshe mbi profilaksinë, por gjatë periudhës time 20 vjeçare si pedagog universiteti nuk kemi folur kurrë në interes të profilaksisë. Çështja e shëndetit është çështje sëmundje, çështje vërtet shëndetsore është ajo që bëj tani. Kam vizionin që jetëgjatësia e mundshme në Hungari të jetë të paktën mbi nëntëdhjet vjeç.

András, si u njohët?

A.B.: Ka 22 vjet, nëpërmjet një lajmërimi në gazetë. Unë atëhere punoja si inxhinjer, dhe si në punë ashtu dhe në personalitet plotësonim mirë njëri-tjetrin.

Cili prej jush vendosi, që të hynte?

A.B.: Teca ma besoi mua. Ishte tërheqëse, që këtu është në rregull ana



ligjore dhe firma është prezent në vend. Më parë, në firmën tjetër patëm shumë probleme nga ajo, që nuk funksiononte kështu. Nuk ndodhi një herë që të jepnim një milion forinta në një stacion benzine, që pastaj të sillnin mallin nga jashtë.

Si ishin muajt-vitet e fillimit?

A.B.: Në krahasim me sot ishte më e lirshme dhe e thjeshtë. Tani janë shumë në treg, secili të shmanget me atë, që e njeh aloen dhe nga ky moment duhet shumë sforcim, që nga fjala të bëhet biznes dhe është vështirë të gjesh, cili çfarë duron. Unë kam më pak durim për këtë, kështu që më mirë them që gruan e kam mjeke, specialiste në këtë fushë, po të lë një takim me të dhe bisedoni më me hollësi.

Në ç'mënyrë mund të ndihmohet në biznes?

A.B.: Për shumë vjet rrugët nëpër rrethe i kemi bërë bashkë, në pikat më të largëta, sidomos kemi shkuar në perëndim të Hungarisë. Që nga ajo kohë drejtoj makinën, nëse ka nevojë, iki për materiale, ndërtoj marrdhënie. Mund të them kështu, që profesionalisht Teca mban në duar biznesin, ndërsa unë „atmosferën”.

Si po përparoni?

A.B.: Duke u krahasuar u bëmë shpejt soaring, pastaj vrrulli u ndal pak, u bënë edhe dy manager, pastaj për një kohë të gjatë nuk patëm të rinjë. Një arsye është, që tek ne biznesi nuk dominon mbi çdo gjë, sepse jemi të apasionuar pas nipërve dhe kalojmë shumë kohë me ta. Por duhet në çdo mënyrë të hedhim një hap përpara nga kjo gjëndje amullie.

Keni strategji të provuar mirë.

A.B.: Atëhere ishte e mirë. N.q.s. sot do të duam të punojmë me ato metoda, që përdorëm kur nisëm biznesin, ato nuk do të funksionojë, sikurse metodat e sotme nuk do të ishin ideale për atë kohë.

T.S.: Vështirësia e tregut sot është, që njerëzit janë mbyllur brënda vetes, janë bërë më pesimistë. Sipas meje më të sukseshëm do të jenë në biznes ata, që

dinë të afrohen më shumë tek rinia. Edhe për ne kjo është pyetja kryesore: a do të gjejmë rrugë për tek ata, a do të kuptojmë dot.

Teca, para pak kohësh u bërë edhe zyrtarisht mjeke konsulente e firmës. Çfarë do të thotë kjo?

T.S.: Ky është telefoni i kuq. Gjatë orarit të punës mund të telefonojnë dhe të pyesin në lidhje me çështje shëndetsore. Sigurisht, edhe deri tani kam dhënë këshilla, kushdo mund të më kërkonte dhe shpeshherë edhe drejtori rajonal më ka kërkuar mendim në lidhje me produktet e reja apo marketingun, ky besim është një nder për mua.

Çfarë ju stakon juve?

A.B.: Si të gjithë ata që merren me Forever, edhe për ne udhëtimi është një eksperiencë sistematike. Në rally-t amerikan gjithmonë ikim në atë mënyrë, që mbrijmë një javë para se të fillojë ai, organizojmë një lloj “pararally”, shkojmë në vendet më të thella dhe sigurisht edhe në ato më të njohurat. Grand Canyon, Hawaii, Las Vegas parqe kombëtare, Monument Valley... kur u klasifikuar për herë të parë në Amerikë, në podium thashë, dëshira ime është, që dhjetë here njëra pas tjetrës të jem aty. Tani ikim për herë të dymbëdhjetë. Mund të them, që tani Amerikën e njoh më mirë se Hungarinë.

Teca, për ty çfarë është më e rëndësishme sot?

T.S.: Nipërit dhe fëmijët. Unë kam qënë fëmijë i vetëm dhe gjithmonë një shtëpi me oborr ka qënë ëndrra ime dhe brënda saj një tavolinë buke, që do të mbledhi rreth vetes të gjithë familjen – tashmë këtë e kam. Çdo mëngjes me një kafë me qumësht në dorë shëtisim rreth oborrit, shikojmë, cila lule është hapur, çfarë duhet të mbjellim. Tani që përfunduar ndërtimin, shijojmë atë që arritëm.

Çfarë do të jetë motivimi i ri?

T.S.: Nuk do të kem qetësi, deri sa e gjithë familja të mos jetë bashkë në Hawaii



Niveli i lartë në Szirák

TAKIMI
MENAXHERËVE

22.5.2011



Në një mjedis festiv FLP organizon për të nëntin vit takimin e menaxherëve në Szirák. Bashkpunëtorët drejtues u mbledhën në Szirák në një ditë të bukur me diell verbues që së bashku të kalonin jo vetëm një ditë pune por edhe relaksi.

Takimi i menaxherëve në radhë të parë është një takim profesionistësh, por mundësitë qenë të mëdha edhe për tu çliruar pak nga ngarkesa e perdritshme.

Dr Sándor Milesz përshëndeti menaxherët dhe miqtë e huaj. Na nderoi me pjesmarrjen e tij

zv/presidenti i FLP për Europën Aidan O'Hare dhe menaxheri diamant Kim Madsen.

Drejtori i Pergjithshëm theksoi se ky takim është training i elitës, dhe është një privilegj i madh të marrësh pjesë në të ku kusht i pjesmarrjes është realizimi i 600 pikëve (në takim morën pjesë si të ftuar edhe menaxherë të rinj. Ata që janë kualifikuar menaxherë gjatë 12 muajve të fundit.)

Së pari dëgjua Madsen-menaxherin diamant nga Danimarka, me një leksion kuptimplotë dhe ku mund të mësoje shumë. Suksesi, u shpreh Kim, është ai kur njeriu është i sukseshëm dhe rrethohet nga njerëz që duan të mësojnë. Koha fluturon shumë shpejt. Me njerëzit e mirë edhe kur kalon disa orë të duken minuta, ndërsa me njerëzit negativ edhe kur kalon disa minuta të duken disa orë. Mendoni me kë e kaloni kohën, sepse fitimtari në çdo problem shikon mundësitë, ndërsa i humburi në çdo mundësi kërkon të gjejë problemet -theksoi ai. Foreveri, gëzon në botë emrin e markës së shkëlqyer, ku përmendet bashkë me firmat më të fuqishme dhe më të njohura. Çdo ditë në rang botëror në Forever regjistrohen rreth 3 mijë vetë. Çështja qëndron në atë se sa lidhen me ty -theksoi ai, pastaj zbërtheu rolin e internetit në këtë biznes. Jemi në vitin 2011, dhe hapi duhet mbajtur me kohën. Ai propozoi që gjithkush duhet të përgatisë faqen e vet të internetit me ndihmën e : www.myflpbiz.com. Ndërsa Facebook na ofron mundësi të tilla që kurr nuk kanë ekzistuar. Ai tregoi se 5 menaxherët e fundit i kishte sponsorizuar nëpërmjet internetit. Per Kimin suksesi i vërtetë është sigurimi i një jete të tillë që gjithmonë e ke dëshiruar. Gjithkujt i kërkoi që të skicojë çfarë jete dëshiron të jetojë.





Pas leksionit të Kim Madsen u çfaqën punonjësit e kështjellës të Szirakut, ku morëm pjesë në një drekë të tillë në tavolinën e madhe të rrumbullaktë sa pas saj na duhej të pinim produktin Lean për të mos shtuar në peshë.

Anëtarët e Klubit të Presidentit, dhe drejtuesit që muajin e kaluar kishin plotësuar 100 pikë mundën të marrin pjesë në një drekë të veçantë në sallën e madhe të kështjellës në shoqërinë edhe të zëvendës presidentit të FLP për Europën Aidan O'Hare , drejtorit operacional për Europën Péter Lenkey, drejtorit të përgjithshëm Dr. Sándor Milesz dhe diamant menaxherit Kim Madsen. Ishte një ndjenjë fantastike të kaloje një orë me më të mirët. Natyrisht këtu nuk mund të qëndronim pa pak humor, por ndërkohe u shkëmbyen edhe mendime me vlerë për të ardhmen.

Pas drekës fjalën e mori Aidan O'Hare i cili theksoi se nëqse ndërtojmë diçka , atë duhet ta ndërtojmë si më të mirën. Në qoftë se ndërtojmë psh një urë, nuk është njëlloj se me çfarë ndjenjash e përfundojmë atë. Nëqse ndërtojmë urën e artë me të tjera mbresa dhe ndjenja do ta përcaktojmë rrugën tonë, sikur vetëm përmes një kalimi hekurudhor. Aidan foli për kredon e tij, duke nxitur këdo që edhe ne të formulojmë kredon tonë personale. Paralel foli për lidhjen midis sponsorizimit dhe xhiros. Nëqse ka sponsorizim atëhere edhe xhiroja do të rritet, nëqse nuk ka sponsorizim... ,, në botën e biznesit suksesi varet nga ajo se sa i fortë është njeriu. Personaliteti yt në FLP do të përcaktojë edhe të ardhmen tënde. Në gjithë qënien tënda nga brenda duhet rrezatuar pozitivitet. Rex gjithmonë buzëqesh." Aidani na këshilloi që të bëhemi të tillë, me të cilët njerzit do të duan të jenë gjithmonë bashkë.

Veronika Lomjanski – menaxherja e parë diamante e rajonit tonë shtroi pyetjen: cili është shkaku i asaj që je aty ku je konkretisht? Zgjidhjen duhet ta kërkojmë tek vetja, sepse e ardhmja jonë varet nga fokusimi ynë. Veronika këshilloi të mos kapardisemi me atë që kemi arritur, por të qëndrojmë gjithnjë modestë dhe njerzit do të afrohen më shumë me ne.

Ajo propozoi që të mos ,,fërkojmë ,, bashkpunëtorët e vjetër, por të sponsorizojmë njerëz të rinj. Ti japim ndërtimit të biznesit tonë një dinamikë të shëndetshme. Në qoftë se çdo muaj regjistrojmë





4 distributorë të rinj, në fund të vitit do të kemi 48, dhe nga këta do të dalin supervisorë e menaxherë të rinj e sigurisht edhe një pagesë në rritje. Energjia dhe vullti i Veronikës bën për vete gjithkënd.

Serinë e leksioneve e mbylli diamanti më i ri i rajonit Miklós Berkics . Tregoi me shëmbuj historitë interesante të prezantimit, duke futur në to edhe pjesë humori, sepse gjëra të tilla mbeten në mendjen e njerzve. Tregoi se bota e jashtme që na rrethon, është pasqyrim i botës tonë të brëndshme. Në qoftë se njeriu është negativ, atëhere ai njerëz të tillë do të tërheq tek vetja, por nqse njeriu është pozitiv dhe me shpirt, atëhere ai të tillë do të tërheq tek vetja; ky është ligji i jetës. Këshilloi që të thërrasim në këtë biznes sa më shumë sipërmarrës. Atij që i shkon mirë sipërmarrja ti flasim për atë që vërtet ka kapacitete të lira, ndërsa atyre që nuk u ecën mirë biznesi i tyre tu themi se këtu kanë një mundësi të shkëlqyer. Edhe sikur të mos njohim sipërmarrës, njohim njerëz që kanë lidhje me sipërmarrësit. Ky është zinxhiri i marketingut në rrjet (MLM)!

Miklós pyeti dy nga bashkëpunëtorët e tij drejtues, që kanë marrë pjesë në prezantimin e tij në fillim të punës në FLP, se çfarë u kujtohej nga ai prezantim. Informacionet apo detajet e asaj kohe nuk i mbajnë mend , por një gjë po: atë që Miklosit i ndritnin sytë dhe frymëzimi i tij ishte i lartë.

Por atëhere nuk kish kostum të bukur apo veturë të shtrenjtë. Por besimi në realizimin pa kufi të mundësive të Foreverit ndezi energji dhe një zjarr të tillë sikur edhe atëhere të kish qenë me kostumin më të mirë dhe me veturën më të bukur.

Pastaj thirri një menaxher të ri, të cilin e pyeti, çfarë mbante mend nga disa muaj më parë? I riu po ashtu u pergjigji se po ashtu si ata që ishin takuar 14 vjet më parë po ai pasion, po ai zjarr, po ai besim e kishte kapur edhe atë. Sipas diamant menaxherit kjo ka rëndësi, vetëm kjo ka rëndësi. Pastaj theksoi se koha ecën, ajo nuk na pret! „Merr një vendim dhe realizo enderrat e tua me ndihmën e Foreverit!”

Pas leksioneve Attila Pattaki dhe Edda dhanë një koncert të ndezur , duke krijuar një atmosferë të tillë që nuk e kishim parë ndonjë herë. Si për ta mbyllur ditën iu perveshëm edhe një herë ushqimeve të shijshme që na prisnin në tavolinën e madhe të rrumbullaktë, duke marrë kështu si dhuratë edhe një ditë tjetër të mrekullueshme.

Në të ardhmen le të jesh atje me ne edhe Ti , të shikosh madhësinë e kësaj firme, të ndjesh energjinë e pakufishme që rrezatohet nga këta njerëz të sukseshëm dhe të mësosh nga më të mirët. Mos harro vetëm 600 pikë duhen!

Tibor Lopicz dhe Orsolya Lenkó Lopiczné
Senior menaxherë
Anëtarë të Klubit të Presidentit





TË REJA? KARRIER FOREVER-I!

Forever lojtar i faktorit vendimtar në treg hyri në vitin e tridhjetekatërt në afër 150 vende, dhe nisi vitin e pesëmbëdhjetë të suksesshëm të Forever Living Products Hungari bashkë me rajonin e sllavëve të jugut dhe Shqipërinë.

Disa mijra njerëz dhe familje ndërtojnë tashmë biznesin shumëgjeneratësh të Forever-it. Produktet e firmës me një cilësi shumë të lartë dhe plan marketingu më të fortin në botë përballuan provat e dhjetëvjeçarëve, vërtetuan që mund të ndërtojnë për ata një biznes stabël, që mund të planifikohet dhe që siguron të ardhura.

I njohur prej kohësh në botë, ndërsa në rajonin tonë ky evolucion i ri u njoh në vitet e fundit, solli në publik një nocion të ri të ndryshimit të menjëhershëm të fatit: Karrierë Forever-i. Karriera bën fjalë për ata njerëz, që për një periudhë të gjatë kohe duan ta lidhin veten e tyre me një zanat, me një prirje. Duan të bëjnë gjëra të tilla, të cilat i bëjnë ata të lumtur, me të cilën mund të plotësojnë, mund të realizojnë ëndrrat, mund të prodhojnë vlera të qëndrueshme, gjatë gjithë jetës mund t'ju a japin këtë edhe të tjerëve, dhe do të dëshironin të jetonin me një punë të ndershme, duke siguruar familjet e tyre.

Kjo vazhdon të jetë aktuale, edhe sot funksionon. Është në rrethana komplet të reja, por edhe në lindje ka jetuar një herë një karrierë-imagjinuese "40 vjet në një zanat". Çfarë mbeti nga kjo në vendet e rajonit tonë? Nostalgjia, dëshira, përpjekje të dëshpëruara. Mbetën premtime të zhurmshme, rroga poshtëruese, mënyrë jetese që nuk mund të llogaritej, pushime nga puna, papunësi, modele-karriere boshe, të pa planifikueshme.

Karriera në Forever është një njollë boje e re, një përfaqësues me vlera të sigurta, një ofertë e re në koleksionin e modeleve të karrierës. Sigurisht që nuk është e vetmja, dhe jo të gjithë do ta zgjedhin atë. Kjo është "vetëm" një MUNDËSI fantastike. Në krahasim me të tjerat kjo ka vërtetuar, për tridhjet e katër vjet që funksionon për TË GJITHË në lindje, në perëndim, në veri dhe jug. 18-28 vjeçarë dhe mijra grupmosha të tjera nisin çdo ditë karrierën e tyre në Forever, zgjedhin si zanat të tyre parimin "të pasurohesh duke pasuruar të tjerët".

Lidh edhe ti kontratë me firmën e Rex Maughan-it merr më në fund në duart e tua drejtimin, më në fund të të mbushet kupa me atë që, të hedhin andej-kënde, të mbajnë me fjalë, premtime, që gjithmonë të tjerët të thonë, çfarë është e mirë për ty. Nise të ardhmen tënde, shfrytëzo mundësin, që një firmë botërore prej 3 miliard dollarësh të merr seriozisht, të vlerëson dhe të pranon si partner.



Tibor Radóczy
Soaring menaxher
Drejtor rajonal

CONQUISTADOR

TOP 10 CLUB

SERBIA



1. DRAGANA JANOVIĆ
MILOŠ JANOVIĆ
2. VLADIMIR JAKUPAK
NEVENKA JAKUPAK
3. PRVOSLAVA MILETIĆ
4. JOVANKA STRBOJA
RADIVOJ STRBOJA
5. MILENA PETROVIĆ
MILENKO PETROVIĆ
6. PETAR AČIMOVIĆ
MILANKA AČIMOVIĆ
7. KORÓDI KOVÁCS ELIZABETA
KORÓDI JÓZSEF
8. JASNA HRNČJAR
9. MARIJA KOBILJSKI
DJORDJE KOBILJSKI
10. VECKA VELKOVSKA

SLLOVENIA



1. JOŽICA ARBEITER
DR. MIRAN ARBEITER
2. TOMISLAV BRUMEC
ANDREJA BRUMEC
